

PedaKos

Aleanca për Zhvillimin e Edukimit
Parashkollor për Kosovën

Raport shkencor i monitorimit

Janar 2023

HARTIMI I RAPORTITI U REALIZUA NGA: Mevlude Aliu Gashi - Hulumtuese në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Personat e intervistuar: (Drejtoreshat dhe Edukatorët e kopshteve): Azemine Aliu, Bukurije Gashi, Danijela Markovic, Drita Rexhepi, Edi Puka, Fatime Demolli Mustafa, Fatmire Rugova, Indire Zenelaj, Mentore Vokshi, Mejreme Rugova, Merita Halitaj Beqiri, Merita Rexhepi, Shpresa Hoxha, Sladjana Stanojkovic, Kimete Hoxha Jakupi, Mikete Hajdari, Leurita Valla, Engjeline Dukaj, Shkurte Bojniku, Blerta Noci, Laureta Hasanaj, Teuta Nrecaj, Klodina Krasniqi, Mevlude Murtezi, Amanda Shkoza, Arbenita Basha, Kadrije Asllani.

HYRJE

Projekti PEDAPOS (Aleanca për zhvillimin e edukimit parashkollor për Kosovën) është një projekt tre vjeçar (2019/2022) i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, dhe i implementuar nga OJQ Volontari del Mondo – RTM, me mbështetje të Ambasadës Italiane në Kosovë.

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte mbështetja e institucioneve publike dhe palëve private të interesit në zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, në kuadër të komponentit të fëmijërisë së hershme (0-5), kurse objektivi specifik është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të arsimit (mosha 3-5) të cilat ofrohen nga kopshtet publike, private dhe me bazë në komunitet.

Rritja e cilësisë së shërbimeve në kuadër të arsimit parashkollor bazohet në tri shtylla:

- a) mbështetje ndaj kompetencave të stafit parashkollor përmes ofrimit të trajnimeve profesionale;
- b) nxitje, përmes shkëmbimit të praktikave të mira, e përqafimit të një qasjeje edukative të bazuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe potencialeve të fëmijëve, si dhe në ndarjen e përgjegjësisë në mes të palëve të sektorit;
- c) zbatim i partneritetit publiko-privat përmes reformimit dhe ringritjes së Kolegjiumit të Institucioneve Parashkollore.

Në këtë kuadër, PEDAPOS i referohet dhe e ofron Qasjen Reggio Emilia (QRE), së bashku me një sistem të ndërlidhur të edukimit dhe përvojave, duke pasur parasysh që këto praktika të mira njihen ndërkombëtarisht në fushën e edukimit të fëmijërisë së hershme.

Puna e PEDAPOS-it bazohet në një partneritet i cili përfshin, si palët kryesore të cilat përfaqësojnë përvojat e Reggio Emilia-s si Komuna e Reggio Emilias – Institucioni i Kopshteve dhe i Çerdheve (IKÇ), Fondacioni E 35 (E35), si dhe Fondacioni Reggio Children (Qendra Ndërkombëtare Loris Malaguzzi (FRCH), ashtu Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK), Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës (FE-UP), si dhe tre ofrues të shërbimeve edukative, siç janë Kopshti Botanika, OJQ ChildProof dhe OJQ Shpresa e Jetës.

Sa i përket dy shtyllave të para të projektit, personelit të 15 kopshteve të Kosovës – të cilat e përfaqësojnë të gjithë territorin kombëtar si dhe të gjitha format e institucioneve parashkollore, përfshirë minoritetet etnike dhe fetare – iu është ofruar mundësi trajnimi (virtualisht dhe me prani fizike) lidhur me parimet, vlerat dhe praktikën e QRE-së. Në të njëjtën kohë, projekti u ka ofruar Institucioneve parashkollore material mbështetës në mënyrë që t'ua mundësojë të njëjtave t'i interpretojnë dhe t'i implementojnë në praktikë përmbajtjet

dhe pikëpamjet teorike. Poashtu, u realizua edhe vizita studimore në Reggio Emilia në Itali, me pjesëmarrje të të gjitha edukatoreve dhe drejtoreshave të përfshira në projekt, si dhe përfaqësuesit e partnerëve të projektit nga MASHTI, IPK dhe FEUP, që ishte një mundësi shumë e mirë për zhvillim profesional dhe për përfitim të përvojave për zbatimin e QRE.

Projekti ka ofruar mbështetje në rregullimin e hapësirave të kopshteve dhe janë pajisur me instrumente dhe materiale relevante për t'i zhvilluar aktivitetet e frymëzuara sipas QRE-së.

Në këtë kuadër, IPK-ja ka marrë pjesë në programin e trajnimeve dhe në aktivitetet e shkëmbimit të praktikave të mira, si dhe ka pasur rolin e monitorimit shkencor të projektit. Ky aktivitet ka nënkuptuar të raportuarit se si ndryshimet e promovuara nga projekti, në pikëpamje të qasjes pedagogjike dhe praktike, janë zbatuar nga 15 kopshtet pilot, me qëllim të vlerësimit të progresit dhe të zhvillimeve gjatë ecurisë së projektit.

Ky aktivitet monitorimi është zhvilluar për herë të parë në tremujorin e fundit të vitit 2021, për të vazhduar më pas në vitin 2022 me nga dy vizita monitoruese në secilin kopsht pilot, të cilat janë realizuar gjatë muajve qershor-dhjetor 2022.

Ky dokument është raportues i fazës së dytë të monitorimit shkencor të procesit PEDAKOS dhe i njëjti përfshin gjetjet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet.

QASJA REGGIO EMILIA (QRE)

Qasja Reggio Emilia është një filozofi edukative e bazuar në të imagjinuarit e fëmijës si qenie me potenciale të larta për zhvillim, si dhe të qenit një subjekt me të drejta i cili mëson përmes njëqind gjuhëve të cilat i përkasin të gjitha qenieve njerëzore dhe ku i njëjti rritet në marrëdhënie me të tjerët.

Kjo qasje bazohet në një seri vlerash themelore:

- Punë kolegjiale dhe e bazuar në marrëdhënie për të gjithë punëtorët
- Prani ditore e një morie edukatoresh dhe mësuesish më fëmijët
- Atelieja dhe atelieristi
- Kuzhinat brenda kopshteve
- Mjedisi si një edukator
- Dokumentimi për të bërë të dukshëm procesin e të nxënit kreativ
- Grupi i bashkërendimit të praktikave pedagogjike dhe edukative
- Pjesëmarrja e familjeve

Fëmijët pajisen me potenciale të jashtëzakonshme për nxënie të cilat shndërrohen në një manifestim të një shkëmbimi të pa ndalur me kontekstin kulturor dhe atë shoqëror.

Çdo fëmijë është subjekt i së drejtës. Çdo fëmijë, individualisht apo në marrëdhënie me grupin, është ndërtues i përvojave të cilave ata iu japin kuptim dhe përmbajtje.

Fëmijët, si qenie njerëzore, janë në pronësi të njëqind gjuhëve: njëqind mënyra të menduarit, shprehurit, kuptimit, si dhe takimit me tjetrin përmes të menduarit që na bashkon dhe nuk na ndan nga dimensionet e përvojave të ndryshme. Njëqind gjuhët janë metaforë për potencialin e jashtëzakonshëm të fëmijëve, për ndërtimin e njohurive të tyre dhe të proceseve kreative, për format e pafundme përmes së cilave shfaqet jeta dhe ndërtohet njohuria.

Është përgjegjësi e qendrës për fëmijë, si dhe e institucionit parashkollor, t'i japë vlerë gjuhëve verbale dhe jo verbale përmes një dinjiteti të barabartë.

Çdo fëmijë, sikurse çdo qenie njerëzore, është ndërtues i njohurive, kompetencave dhe autonomive.

Procesi i të nxëniet privilegjon strategjitë kërkimore, shkëmbimin dhe diskutimet, si dhe pjesëmarrjen me të tjerët.

Kërkimi përbën një dimension esencial të jetës së fëmijëve dhe të rriturve, një tension drejt njohurisë për t'u njohur dhe për t'u vlerësuar. Prioritet i jepet kërkimit në mes të rriturve dhe fëmijëve si një praktikë e përditshme, një sjellje e nevojshme për të interpretuar kompleksitetin e botës dhe një instrument i fuqishëm i ripërtëritjes së edukimit.

Kërkimi, i shpërfaqur përmes dokumentimit, ndërton nxënien, riformulon njohurinë, është në themel të cilësive profesionale, kurse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar shndërrohet në një element dhe garantues i inovacionit pedagogjik.

Dokumentimi është një pjesë integrale e teorive dhe praktikave të edukimit dhe u jep atyre strukturë.

Kjo e bën të dukshme dhe të vlerësuar natyrën e procesit të edukimit, është subjektive në grupe, tek fëmijët dhe të rriturit, si dhe i nxit ata drejt një trashëgimie të përbashkët.

Veprimi edukativ gdhendet përmes projektimit/dizajnit të didaktikës, mjedisit, pjesëmarrjes, ngritjes profesionale të personelit, dhe jo përmes aplikimit të programeve të paracaktuara.

Projektimi/dizajni realizohet përmes sinergjisë së ngushtë në mes të organizimit të punës dhe kërkimit edukativ.

Organizimi i punës, hapësirave, i kohës për fëmijë dhe të rritur, janë pjesë strukturore e vlerave dhe përzgjedhjeve të projektit të edukimit.

Organizimi ndërton një rrjet të përgjegjësive të cilat ndahen me të tjerët në nivel të administratës, politikave dhe pedagogjisë. Kushtet e punës, si dhe format e kontratave, të cilat krijojnë stabilitet, vazhdueshmëri dhe ndjenjë të përkatësisë kanë një rendësi të veçantë.

Hapësirat e brendshme dhe të jashtme të qendrave për fëmijë dhe institucioneve parashkollore janë të dizajnuara dhe të organizuara në forma të ndërlidhura. Të njëjtat iu ofrohen fëmijëve dhe të rriturve si hapësira për të qëndruar së bashku dhe për të bërë kërkime. Mjedisi ndërvepron, ndryshohet, dhe merr formë sipas marrëdhënies që krijohet me projekt dhe me përvojat e nxënies, në një dialog të vazhdueshëm në mes të arkitekturës dhe pedagogjisë.

Përkujdesja ndaj mobileve, objekteve, si dhe ndaj hapësirave ku zhvillohen aktivitetet përbën një akt edukimi i cili prodhon mirëqenie psikologjike, prodhon një ndjenjë familjeje dhe përkatësie, një ndjesi estetike dhe një kënaqësi të qëndrimit. Po ashtu ka premisa primare dhe kushte mbi sigurinë në mjedise, një cilësi kjo e prodhuar nga dialogu dhe nga elaborimet e ndara në mes të profileve të ndryshme të profesionistëve të cilët merren dhe përkujdesen me këtë aspekt.

Ngritja/formimi profesional është një e drejtë dhe detyrë të secilit punëtor dhe e grupit, e përfshirë dhe e cilësuar si pjesë e orarit të punës dhe i organizuar brenda kolegjalitetit nga pikëpamja e përmbajtjes, formës dhe mënyrës së pjesëmarrjes së secilit pjesëmarrës.

Zhvillimi profesional zbatohet në sinergji në mes të takimeve ‘për përditësim’ të personelit në institucionet parashkollore dhe qendrat për fëmijë, planit për formim dhe ngritje profesionale në sistemin e shërbimeve edukative të qytetit, si dhe mundësive edukative dhe kulturore në qytet, në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Pjesëmarrja është një strategji e edukimit e cila ndërtohet dhe jetohet përgjatë takimeve dhe marrëdhënieve të përditshme. Pjesëmarrja i jep vlerë dhe i shfrytëzon njëqind gjuhët e fëmijëve dhe qenieve njerëzore, të cilat kuptohen si një pluralitet i pikëpamjeve dhe i kulturave.

Pjesëmarrja prodhon dhe i informon ndjenjat e kulturës së solidaritetit, përgjegjësisë dhe përfshirjes, si dhe prodhon ndryshime dhe kultura të reja.

Vlerësimi është një proces i cili i strukturon përvojat e edukimit dhe punën e kopshteve dhe është pjesë e secilit aspekt të jetës së një kopshti, dhe si i tillë kuptohet si akt publik i dialogut dhe interpretimit.

Me këtë objektiv në mendje, qendrat për fëmijë dhe institucionet parashkollore janë të pajisura me Kartelë për Shërbime, Këshillat e Qyteteve për Fëmijë, grupet e bashkërendimit pedagogjik, grupet kolektive të punës me kopshte si dhe prania, përgjegjësia dhe pronësia e përbashkët e stafit edukativ – përfshirë praktikantët si dokumentimi, pjesëmarrja e familjeve dhe komunitetit lokal, si dhe pjesëmarrja në sistemin publik të integruar të qytetit.

METODOLOGJIA

Qasja Reggio Emilia është një filozofi edukative, një mendësi, një sjellje kundrejt fëmijëve, të drejtave dhe kapaciteteve të tyre, atëherë nuk është e mundur që të njëjtën ta reduktojmë në kategori aktivitetesh për t’u zhvilluar nga edukatorët. Në këtë kuptim, zhvillimi i instrumenteve të monitorimit për mbledhjen e të dhënave për të analizuar ndryshimet në kuptim të qasjes edukative dhe praktikave, të promovuara nga projekti dhe të zbatuara nga shkollat, përqendrohet në identifikimin e një numri makro-dimensionesh për t’u vlerësuar. Instrumentet e monitorimit janë zhvilluar nga një hulumtues i IPK-së i cili e ka zbatuar të gjithë aktivitetin e monitorimit, më mbështetje të personelit të RTM-PEDAKOS, duke përfshirë edhe mbështetjen profesionale të një pedagogu nga Reggio Children.

Në vazhdim janë të paraqitura makro-dimensionet:

1. Përdorimi i brendshëm dhe i jashtëm i hapësirave;
2. Përdorimi i materialeve;
3. Projekti edukativ;
4. Bashkëpunim me familjet dhe përfshirje e komunitetit;
5. Zhvillim profesional i edukatoreve.

Për secilën nga këto janë identifikuar disa nën-aspekte me qëllim që të sigurohemi se të gjitha veçoritë e secilit makro-dimension janë adresuar. Ky instrument është përdorur për të zbatuar vëzhgimin dhe intervistat gjysmë të strukturuar të zhvilluara nga IPK-ja gjatë vizitave në 14 kopshte¹.

Në 14 kopshte janë realizuar nga dy vizita monitoruese, përmes vëzhgimit në ambientet edukative dhe janë realizuar edhe intervista me edukatore dhe drejtoresha të institucioneve. Vizitat monitoruese janë realizuar pas vizitës studimore të realizuar në Itali, ku edukatoret dhe drejtoreshat kanë pasur mundësinë të përcjellin për së afërmi praktikën e QRE në Itali. Trajnimet dhe praktikën që kanë ndjekë për së afërmi në Itali kanë ndihmuar edhe procesin e monitorimit. Kanë ndihmuar që kjo qasje të kuptohet dhe kanë filluar ndryshimet në kopshte, si për nga rregullimi i mjedisit edhe për nga qasja e tyre në punën me fëmijë, prindër, edukatore tjera të kopshtit, komunitet, shkëmbime pedagogjike me kopshte tjera, etj.

Procesi i monitorimit është realizuar me vizitat në çdo kopsht që kanë adresuar të gjithë rutinën ditore, duke filluar nga vëzhgimi i fillimit të aktiviteteve: arritja e fëmijëve në mëngjes, shërbimi i mëngjesit, zbatimi i aktiviteteve të planifikuara brenda dhe jashtë hapësirave, aktivitetet e lira, dreka dhe pjesa e mbetur. Në hapin e mëtejshëm janë analizuar të dhënat, janë integruar të gjitha elementet e mbledhura nga secili kopsht, të cilat kanë rezultuar me gjetje, me ndryshimet që kanë ndodhur në hapësirat dhe në punën edukative të këtyre kopshteve dhe përfundimet e paraqitura në këtë raport, duke ofruar po ashtu disa rekomandime.

GJETJET E MONITORIMIT

Raporti përfshin rezultatet nga monitorimit në 14 kopshteve pilot të përfshira në projektin PEDAKOS, të cilat janë trajnuar mbi parime, vlera dhe praktika të Qasjes Reggio Emilia, dhe të cilat janë pajisur me hapësira dhe materiale duke ua mundësuar zbatimin e aktiviteteve të

¹ Projekti PEDAKOS përfshinë 15 kopshte pilot në Kosovë, por në raportin e monitorimit janë përfshirë 14 kopshte, që janë të pajisuara me infrastrukturë, materiale dhe mjete nga projekti PEDAKOS dhe janë funksionale. Ndërsa, 1 kopsht (kopshti Gëzimi Ynë në Mitrovicë) ishte në renovim rrënjësor të objektit dhe derisa është realizuar procesi i monitorimit, ky kopsht ishte jashtë funksionit, prandaj raporti përfshin 14 kopshte pilot. Pas procesit të monitorimit, kopshti „Gëzimi Ynë” në Mitrovicë është renovuar, është pajisur me atele, materiale dhe mjete, sikur edhe kopshtet tjera dhe ka filluar punën.

frymëzuara nga kjo qasje. Është edhe një kopsht që është pajisur me inventarë, mjete, materiale dhe trajnime, por nuk është përfshirë në monitorim, sepse ishte në renovim objekti i kopshtit.

Komunat në të cilat shtrihen 15 kopshtet pilot të përfshira në QRE



Kopshtet pilot të përfshira në projektin PEDAPOS dhe të përfshira në procesin e monitorimit, janë kopshte publike, private dhe me bazë në komunitet.




Fig. 1. Llojet e kopshteve

Nga QRE përfitojnë 1754 fëmijë që vijojnë 14 kopshtet pilot, që kanë mundësi të shfrytëzojnë hapësirat, mjetet dhe materialet e ofruara nga projekti PEDAPOS, ndërsa në klasat ku punojnë edukatorët e trajnuara me QRE dhe që kanë qenë pjesë e vëzhgimit dhe monitorimit, janë 14 grupe dhe kanë përfituar 297 fëmijë (151 vajza dhe 146 djem), si dhe në këto klasë janë të përfshirë edhe 9 fëmijë me nevoja të veçanta (4 vajza dhe 5 djem)

1. Përdorimi i hapësirave (të brendshme dhe të jashtme)

Në 14 kopshtet e vëzhguara, klasat ku realizohet puna me fëmijë, janë të ndritshme me dritë natyrore, me temperatura normale dhe të përshtatshme për qëndrimin ditor ose gjysënditor të fëmijëve.

Në 14 kopshtet, përveç edukatoreve të grupit, kanë filluar të angazhohen edhe stafi tjetër në aktivitetet me fëmijë, ndonjëherë për të përkrahur edukatorët në vëzhgim, në fotografim, apo në ndonjë pjesë të realizimit të punës, por jo të jenë pjesë e përditshmërisë, sepse në ambientet e brendshme, në shumicën e kohës fëmijët qëndrojnë në klasa ku janë prezentë dy edukatore në një grup të fëmijëve (në dy kopshte vetëm nga një edukatore është në një grup).

Në 14 kopshtet e vëzhguara, ambienti i shërben vetorganizimit të fëmijëve brenda klasave, ku mund të lëvizin dhe të shërbehen me materialet e nevojshme. Por, është e nevojshme që ky vetorganizim i fëmijëve të bëhet lirshëm në të gjitha hapësirat e kopshtit, siç mund të jenë korridorët, terasat, oborret, atelietë, kuzhina, etj. Janë vetëm 6 kopshte që kanë krijuar mundësinë e lidhjes së klasës me terasën ose me oborrin e kopshtit por edhe si të tilla shfrytëzohen gjithnjë me orar të caktuar, të ndarë në grupe, me mbikëqyrje të përhershme të edukatores, në aktivitet të planifikuar dhe shumë të strukturuar, etj.

Në 14 kopshtet janë shfrytëzuar tri e më shumë hapësira edukative për realizim të punës edukative. Në të gjitha kopshtet është shfrytëzuar hapësira për takimet e përbashkëta, pastaj kanë kaluar në punë me grupe të vogla dhe në hapësirën për mundësi të eksplorimit me materiale të ndryshme brenda klasave, apo në atele, oborr, në tersë, etj. Këto praktika po e shtyjnë procesin, që fëmija të jetë në qendër.

Në 5 kopshte, në hapësirat e atelesë janë vendosur tabelat dritë-hije, ku fëmijët mund të eksplorojnë me materiale të ndryshme, ndërsa në 2 kopshte tjera janë krijuar dhomat e errëta të veçanta për eksplorim me dritë-hije dhe janë pajisur me materiale.

Në 12 kopshte atelietë kanë filluar të shfrytëzohen dhe të pasurohen me materiale dhe jo vetëm nga edukatorët e trajnuara por edhe nga edukatorët e tjera të patrajnuara. Hapësirat e atelesë shfrytëzohen në forma të ndryshme dhe kjo varet edhe nga madhësia e hapësirës së dedikuar për atele, nga numri i madh i fëmijëve në grup dhe numri i fëmijëve përgjithësisht në kopsht, nga mundësia për qasje të lehtë në atele, sepse në disa kopshte atele ndodhet jo afër klasave, varet edhe nga përgatitjet e edukatoreve për të shfrytëzuar si duhet atelienë, nga mënyra e organizimit të punës, etj. Në 2 kopshte atelietë shfrytëzohet vetëm me gjysmën e grupit të fëmijëve me njëri edukatore dhe gjysma tjetër mbetet në klasë me edukatoren tjetër

për arsye se atelietë kanë hapësira të vogla dhe kështu të njëjtat përdoren me rotacion. Ka edhe raste kur ka shumë grupe që e shfrytëzojnë atelienë, por krijohet një orar për secilin grup veç e veç.

Edukatorët kanë nevojë për më shumë përvoja dhe njohuri rreth shfrytëzimit të atelesë, sepse atele nuk nënkupton aktivitet me një numër të caktuar të fëmijëve e me një kohë të caktuar, nuk është pjesë e ngurtë e planifikuar nga edukatorja, por është përgjegjësi e të rriturve t'i japin mundësi fëmijëve të shprehin potencialin e tyre të jashtëzakonshëm përmes „100 gjuhëve të fëmijës” ku fëmijët janë vet protagonist dhe me materialet që kanë në dispozicion ndajnë përvojat me të tjerët dhe në këtë mënyrë njohja e fëmijës pasurohet.

Në të gjitha hapësirat që janë të pajisura atelietë, edukatorët e grupeve tjera kanë mundësi të marrin përvoja nga koleget e tyre të trajnuara gjatë projektit PEDAPOS dhe të përdorin e shfrytëzojnë këto hapësira, materiale e përvoja, por ka nevojë që më shumë të ketë bashkëpunim ndër-kolegial.

Në 14 kopshtet janë shfrytëzuar edhe ambientet e jashtme, por në 4 kopshte ky mjedis është shfrytëzuar për të realizuar aktivitetet e planifikuara ditore me materiale e mjete të ndryshme, e në 10 kopshte mjedisi i jashtëm është shfrytëzuar për aktivitete të lira, ku fëmijët janë vetorganizuar dhe kanë luajtur në këto hapësira.

Në 14 kopshtet janë vendosë tabela në hyrje të kopshtit për vendosjen e dokumentimeve apo punimeve e fëmijëve, ku mund t'i shohin prindërit e fëmijëve.

Në 3 kopshte kanë rregulluar këndin për mbjelljen e perimeve dhe bimëve të ndryshme, ku fëmijët kujdesen për mbjelljen, ujitjen dhe kujdesin ndaj bimëve duke qenë vetë fëmijët pjesë e këtij procesi.

Në 14 kopshtet kuzhina përdoret për të realizuar aktivitetet e planifikuara, si: ëmbëlsira, lëngje të frutave, sallata me pemë e perime, etj., dhe kohë pas kohe po bëhet pjesë hapësirave edukative. Kuzhinieret kanë ndjekur trajnimet e projektit PEDAPOS dhe çdo ditë e më shumë po bëhen pjesë e përbashkët e ndërveprimit me edukatorët e fëmijët. Në 12 kopshte kuzhinieret kanë filluar të mbështesin edukatorët në përgatitjen e ushqimeve, në raste të caktuara dhe në për realizim të planit. Ndërsa, në 8 kopshte, prindërit janë bërë pjesë e kuzhinës, ku bashkë me fëmijët, edukatorët e kuzhinieret kanë përgatitur ushqime. Në 2 kopshte kanë filluar të shtojnë në menynë e tyre, çaj me lëvore pemësh, erëza të ndryshme dhe të përdorin ngjyrat e perimeve për pikturim, përvoja të reja këto të marra gjatë trajnimeve për QRE, por ka nevojë të punohet më shumë që kjo të bëhet pjesë e edukimit dhe kulturës që në fëmijërinë e hershme.

2. Përdorimi i materialeve

Në 14 kopshte prezantimi i materialeve për fëmijët është bërë ashtu siç kanë marrë përvoja nga trajnimet për QRE. Materialet janë vendosur në vendet e caktuara, në kohë të caktuar dhe në sasi të caktuar.

Në 14 kopshte janë përdorur materiale të mjaftueshme, të shumëllojshme dhe të qasshme për fëmijët, janë përdorë materiale të riciklueshme dhe materiale të natyrës, që janë përdorim të përditshëm në klasa dhe në atele, por që duhet të jenë më të pavarur fëmijët në eksplorimin me materiale të tilla dhe pa u kufizuar në skema të gatshme.

Në 14 kopshte materialet e prezantuara kanë të bëjnë me aktivitetin që do të realizohej.

Mjetet tjera teknologjike (lloptop, kamerë, tabelë, tavolinë me dritë, tavolinë me pasqyrë, etj) që kopshtet janë furnizuar nga projekti PEDAKOS, janë duke u shfrytëzuar nga të gjitha kopshtet që i kanë në dispozicion këto mjete, por që ka ende nevojë për profesionalizëm të edukatores për të realizuar në mënyrën më të mirë përdorimin e këtyre mjeteve nga fëmijët dhe për zhvillimin e tyre gjatë përdorimit të materialeve (për të përdorur materiale të tejdukshme, të errëta, të ndritshme, me vrima, të vendosura në dy dimensional, në tri dimensional etj..)

Materialet në kopshtet publike sigurohen nga buxheti i ndarë nga komuna, në kopshtet private sigurohen nga vet kopshti, ende janë duke shfrytëzuar materialet që i ka sjellë projekti PEDAKOS, ndonjëherë materiale sjellin edhe prindërit, edukatorët, OJQ të ndryshme etj. Në 3 kopshte kanë filluar të deponohen materiale që kanë sjellë nga bashkëpunimet me komunitetin dhe prindërit dhe të përdoren nga të gjitha edukatorët e kopshtit dhe fëmijët.

Drejtoreshat dhe edukatorët e trajnuara bëjnë përpjekje që të përcjellin te edukatorët tjera të kopshteve informata dhe përvoja për mënyrën e përdorimit të materialeve dhe mjeteve në punën me fëmijë, por që këtu ka ende nevojë të punohet për të arritur rezultate.

3. Projekti edukativ

Projektet edukative kanë filluar të bëhen pjesë e kopshteve tona, falë QRE dhe projektit PEDAKOS. Në 14 kopshtet, tashmë është realizuar së paku një projekt, në shumicën e rasteve nga edukatorët që kanë qenë pjesë e projektit, por në disa raste edhe nga edukatorët që nuk kanë qenë pjesë e projektit.

Këto projekte, të nxitura nga projekti PEDAKOS dhe të mbështetura me materiale e mjete dhe të realizuara nga drejtoreshat, edukatorët, prindërit dhe fëmijët, kanë qenë projekte me ide të ndryshme por që kanë sjellë shumë bashkëpunim dhe po shërbejnë si pikënisje për bashkëpunime të tjera, për t'i bërë prindërit dhe komunitetin pjesë të kopshtit.




Fig. 2. Grupet e fëmijëve sipas moshës

Sa i përket projekteve tjera, secili kopsht është duke bërë përpjekje të gjej mënyrën se si të shtrijë përvojat e edukatoreve të trajnuara, të grupet e tjera brenda kopshtit, por edhe jashtë kopshtit, duke prezantuar projektet e realizuara dhe duke marrë ide për projekte tjera.

Në 4 kopshtet ku edukatorët punojnë me fëmijët e moshës 5-6vjet, plani zërthehet nga programi lëndor dhe Kurrikula bërthamë për klasën parafillore, të cilat janë dokument zyrtar nga MASHTI. Plani dymujor përgatitet nga aktivi i edukatoreve të komunës për të gjitha edukatorët parafillore (në kopshte, shkolla, qendra me bazë në komunitet, etj.) dhe të njëjtin plan ato kanë mundësi të përshtatin për fëmijët e grupit vetëm aktivitetet ditore. Këto aktivitete edukatorët bëjnë përpjekje t'i realizojnë sipas QRE edhe pse ka vështirësi, sepse kjo qasje nuk e përkrahë paraprogramimin e punës me fëmijë por projektimin e bazuar në interesat e fëmijëve të grupit përkatës.

Në 7 grupe të fëmijëve, edukatorët nuk bazohen shumë në dokumentet zyrtare të MASHTI-it, por kanë një plan vjetor të paracaktuar me tema mujore, të cilin e përgatisin para fillimit të vitit shkollor dhe ato tema i zërthejnë në javë e ditë gjatë vitit.

Bazuar në procesin e monitorimit të realizuar në këto grupe, në 2 grupe tema e trajtuar për projekt ka rrjedhë nga interesimi i fëmijëve të grupit dhe edukatorët e kanë planifikuar punën e tyre bazuar në kureshtjen dhe interesimin e fëmijëve që e kanë shfaqë gjatë vëzhgimit dhe dokumentimit në një moment të caktuar dhe që kjo përvojë ka nevojë të zgjerohet më shumë.

Ndërsa 1 grup ka planifikuar punën bazuar në nevojat e komunitetit për të rritur bashkëpunimin me familjen dhe për të vetëdijësuar komunitetin për rëndësinë e edukimit parashkollor, duke bërë projekt javor me pjesëmarrjen e prindërve në aktivitete të përditshme me fëmijë në kopsht. Ky projekt ka dalë nga nevoja për të rritur numrin e fëmijëve të përfshirë në edukim parashkollor, në atë pjesë të komunitetit që më pak e frekuentojnë këtë nivel të edukimit.

Vëzhgimi i fëmijëve gjatë realizimit të aktiviteteve bëhet nga edukatorët në 14 grupet. Kjo përvojë e fituar nga QRE është përvetësuar, por vëzhgimi ka mbetur në fazën e përshkrimit të

fjalive që thonë fëmijët, bëjnë foto, video, marrin punime të fëmijëve, etj. por ende kanë nevojë për të përfituar përvoja që të kalojnë në vëzhgimin me qëllim për të njohur potencialin e fëmijëve dhe për të hartuar projekte bazuar në nevojat e fëmijëve.

Në 4 kopshte përdoret „ Instrument për vëzhgimin e zhvillimit dhe të të nxënit në fëmijërinë e hershme, bazuar në dokumentin e Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç”² i hartuar nga Save the Children dhe i miratuar nga MASHTI. Në 4 grupet që kanë fëmijë të grup-moshës 5-6 vjeç përdoren Listë kontrolli për të gjitha fushat e kurikulës për secilin fëmijë, por këto instrumente përdoren për të shikuar arritjet ose ngecjet e fëmijëve, krahas treguesve dhe rezultateve që kanë vendosur paraprakisht, kanë këtë qëllim dhe shërbejnë për të gjitha kopshtet e Kosovës.

Kjo ndryshon nga vëzhgimi sipas QRE, që bazuar në një fokus vëzhgimi, të hartohen instrumente për nevojat e një fëmije, ose të një grupi të fëmijëve dhe bazuar në këto vëzhgime të planifikohet projekti i ardhshëm në një grup apo në një kopsht. Në asnjë kopsht nuk është përgatitur një instrument vëzhgimi i tillë dhe kjo është e nevojshme të bëhet në të ardhmen, sepse edukatorët nuk e kanë praktikuar ende.

Dokumentimi poashtu realizohet në 14 kopshtet duke ruajtur fjalitë e fëmijëve, duke i vendosur ato krahas fotove që kanë bërë, duke i bërë fotot në nivelin e fëmijës, duke i vendosur në tabelën e informatave të prindërve, në korridore të kopshteve, duke i vendosur në dosje të fëmijëve, etj. Por procesi ka arritur deri në këtë fazë dhe kopshtet ende nuk kanë filluar që bazuar në ato dokumentime të projektojnë punën për fëmijë.

Sa i përket krijimit të një hapësire për dokumentim dhe trajnim, nuk është krijuar kjo hapësirë në asnjërin nga kopshtet. Krijimi dhe shfrytëzimi i një hapësire të tillë, do t’u shërbente edukatoreve të trajnuara me QRE, për t’i vendosur dokumentimet e realizuara gjatë punës me fëmijë dhe bazuar në ato, të planifikojnë tema dhe projekte sipas nevojave dhe interesave të fëmijëve. Kjo hapësirë do të shërbente për të ofruar përvoja për edukatorët e patrajnuara për QRE dhe do të kishin mundësi të shfrytëzojnë modele të projekteve të realizuara, që do të vendoseshin në atë hapësirë.

Stafi edukativ është duke përdorur zyret e drejtoreshave, ateletë apo korridoret për t’u mbledhur edukatorët dhe bashkëbiseduar për rezultatet e arritura në punë, për planet e javës së ardhshme, për ndonjë përvojë të re të fituar nga QRE, apo për ndonjë temë tjetër në interes të kopshtit, edukatoreve apo fëmijëve, por jo mirëfilli një hapësirë që do të ndihmonte shtrirjen e QRE në gjithë grupet e kopshteve.

Sa i përket mbështetjes profesionale që u ofrohet fëmijëve me nevoja të veçanta, 8 kopshte kanë psikologe, 2 kopshte kanë edukatore mbështetëse, dhe 4 kopshte nuk kanë shërbim shtesë për fëmijët me nevoja të veçanta dhe kjo është një vështirësi në vete për këto kopshte, sepse kanë fëmijë me nevoja të veçanta në grupe dhe nuk kanë mbështetje profesionale për

² Instrument për vëzhgimin e zhvillimit dhe të të nxënit në fëmijërinë e hershme, bazuar në dokumentin e Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, MASHTI, Save the Children-2019 https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/ALB_Instrumenti.pdf

ata fëmijë. Në 5 komuna janë funksionalizuar Ekipet Komunale për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta dhe 8 kopshte të këtyre komunave, janë në pritje të mbështetjes që do u jepet fëmijëve nga ky ekip profesional. Ka nevojë për asistente për fëmijë me nevoja të veçanta.

4. Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin

Sa i përket përfshirjes së prindërve në takime, 7 kopshtet që kanë filluar vitin shkollor në shtator kanë mbajtur takimet me prindër rreth mesit të shtatorit, ndërsa 7 kopshtet tjera, që kanë qenë në grevë deri më 3 tetor, kanë mbajtur takimet me prindër në tetor të vitit 2022. Në këto takime të fillimvitit, janë prezantuar edhe planifikimet që janë bërë për të rritur bashkëpunimin e kopshtit me familjen, si dhe për rëndësinë që prindërit të jenë pjesë e kopshtit. Prindërit janë informuar rreth projektit PEDAKOS dhe kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim për të mirën e fëmijëve të tyre.

Për përfshirjen e prindërve në aktivitete me edukatore dhe fëmijë, tashmë janë realizuar projekte në 15 kopshte, të nxitura nga projekti PEDAKOS dhe në bashkëpunim me drejtoreshat dhe edukatorët, me qëllim të përfshirjes së prindërve në aktivitete të përbashkëta. Janë realizuar aktivitete me prindër dhe kanë rezultuar me shumë sukses. Projektet që u realizuan me prindër ishin: Portreti; Bluza ime; Ushqimet e shëndetshme; Portreti në hije-SOS Kopshti; Një mbrëmje nën tenda; Përgatitja e tortelinit me baballarët; Mbjellja e luleve; Mbjellja e drunjëve; Kafsha e preferuar; Leximi i librave në shesh të qytetit; etj.

Në 14 kopshtet, prindërit janë të gatshëm të sjellin materiale sipas kërkesës dhe nevojave të kopshtit. Zakonisht sjellin materiale ricikluese dhe të natyrës. Materialet didaktike të kopshtit publike sigurohen nga komuna, nga OJQ të ndryshme, nga vet edukatorët, etj.. ndërsa të kopshtet private sigurohen nga buxheti i kopshtit dhe rrallëherë nga ndonjë OJQ ose organizatë tjetër.

Informimin e prindërve për aktivitetet që realizohen, kopshtet e bëjnë në mënyra të ndryshme. Me takime të shkurtra gjatë pranimit dorëzimit të fëmijëve, me takime grupore e individuale sipas nevojës, si dhe kanë krijuar tabela të informimit të prindërve dhe aty vendosen edhe planet afatshkurtra, planet e ndonjë vizite, menyte e ushqimit, njoftime e informata të përgjithshme për kopshtin, por prezantohen edhe dokumentimet e punës me fëmijë gjatë realizimit të aktiviteteve ditore. Në 2 kopshte informimi i prindërve bëhet me email, ndërsa në 12 kopshtet tjera në grupe të mbyllur në facebook dhe viber.

Përfshirja e komunitetit dhe qytetit në 4 kopshtet që kanë fëmijët e grup-moshave 5-6vjeç, kanë realizuar vizita të ndryshme në institucione shtetërore, në organizata, në muze, në sheshe, në parqe, etj., dhe ato vizita janë bërë kryesisht për nderë të festave të ndryshme. Ndërsa, 9 kopshtet që kishin grupet e fëmijëve 4-5 vjeç dhe 3-4 vjeç, kanë realizuar më pak vizita dhe ato në vende më afër kopshteve, si në markete, në lulishte, në park, të lumi, etj.

Këto vizita janë pjesë e planifikuar e planit vjetor të përgatitur më parë, (përveç vizitave që kanë qenë pjesë e projekteve me projektin PEDAPOS).

5. Zhvillimi profesional i edukatoreve

Vizita studimore në Itali ku morën pjesë drejtoreshat dhe nga një edukatore e kopshteve private dhe publike dhe qendrave ma bazë në komunitet, që ishin pilot-projekt, ishte përvoja më e mirë dhe zhvillim profesional teorik dhe praktik, që bëri të kuptohet më mirë QRE dhe të zbatohet me më lehtësi në punën edukative në kopshte.

Vetëm edukatoret e 4 kopshteve kanë ndjekur trajnime tjera përveç trajnimeve e projektit PEDAPOS, ndërsa që nga monitorimi i vitit të kaluar e deri më tani, edukatoret e 10 kopshteve tjera nuk kanë ndjekë trajnime tjera vetëm trajnimet e projektit PEDAPOS.

Shkëmbimet Pedagogjike kanë shërbyer si zhvillim profesional dhe shkëmbim përvojash edhe për edukatoret që nuk e kanë ndjekur trajnimin.

Trajnimet mes edukatoreve në kopshte kanë ndodhë, por më shumë si bartje e informatave dhe përvojave të përfituara nga vizita në Itali, se sa si trajnim të mbështetur në praktikat e vet edukatoreve të trajnuara.

Sa i përket zhvillimit profesional të edukatoreve është bërë një përmbledhje e intervistave me edukatore dhe drejtoresha të kopshteve dhe janë paraqitur në pjesën e rezultateve të intervistës.

PËRMBLEDHJA E INTERVISTAVE NGA EDUKATORET DHE DREJTORESHAT

Bazuar në instrumentin e monitorimit, është realizuar vëzhgimi në kopshte për të parë për së afërmi realizimin praktik të QRE dhe për përparësitë dhe vështirësitë gjatë realizimit. Por, nga vëzhgimi nuk mund të mblidhen të gjitha informatat e rëndësishme për këtë qasje, prandaj është realizuar edhe intervistë gjysëm e strukturuar, ku rezultatet e intervistave janë përmbledhur dhe do të prezantohen më poshtë.

Hapësirat: Sa u përket hapësirave edukatoret dhe drejtoreshat kanë theksuar se nga realizimi i vizitës studimore në Itali, kanë përfituar shumë nga aspekti teorik dhe praktik, si dhe kanë filluar të ndryshojnë qasjen e deritashme në kopshte. Kanë filluar të përdorin hapësirat e atelesë, të shfrytëzojnë më shumë ambientin e jashtëm, të përdorin kuzhinën si hapësirë edukative, duke përgatitur ushqime me fëmijë, por në disa raste edhe me prindër, etj.

Nevojat janë që të trajnohen më shumë për përdorimin e hapësirave të tjera jashtë klasës, si të brendshme dhe të jashtme, korridoreve, ateliesë, kuzhinës, terasës, oborrit, etj. Duke qenë se në 2 kopshte vetëm një edukatore punon me një grup fëmijësh dhe në 12 kopshtet tjera punojnë nga 2 edukatore në grup, por që në 10 kopshte prej tyre, edukatoret nuk janë bashkë gjatë gjithë ditës por vetëm 3 orë, sepse punon njëra paradite e tjetra pasdite, si dhe në 2

kopshte nga dy edukatore punojnë gjithë ditën bashkë. Kjo paraqet vështirësi sipas drejtoreshave dhe edukatoreve, sepse në pjesën e paraditës, gjatë aktiviteteve janë pak edukatore me fëmijë, nuk ka atelirist/e dhe nuk kanë mundësi që fëmijët në të njëjtën kohë të shfrytëzojnë të gjitha hapësirat dhe të kenë vetëm një ose dy edukatore në mbikëqyrje të grupit të fëmijëve.

Për shfrytëzimin mirëfilli të ateliesë, për t'i dhënë mundësinë fëmijëve të shpreh „100 gjuhët” e tyre, edukatorët dhe drejtoreshat shprehen se kanë ende nevojë për përfitim të përvojave, sepse edukatorët tona nuk kanë përgatitje artistike, për të shfrytëzuar në mënyrën më të mirë atelenë, prandaj kanë rezerva nëse janë duke e realizu mirë punën.

Përdorimi i materialeve: Sa i përket përdorimit të materialeve dhe mjeteve, edukatorët dhe drejtoreshat deklaruan se tashmë kanë marrë përvoja të mjaftueshme nga projekti dhe se janë duke i realizuar në mënyrën më të mirë. Po bëjnë përpjekje që përvojat t'i përcjellin edhe të edukatorët tjerë të patrajnuara. Në 9 kopshte edukatorët e patrajnuara kanë filluar t'i pasurojnë klasat e tyre me materiale dhe mjete duke marrë përvoja nga koleget e tyre të trajnuara, ndërsa në 5 kopshte të tjera, edukatorët e patrajnuara kanë hezituuar të ndryshojnë qasjen e punës së tyre dhe nuk kanë pranuar përvoja të reja nga koleget e tyre dhe drejtoresha, duke kërkuar të ofrohen trajnime edhe për ato, nga profesionistët jo nga koleget e tyre.

Në 14 kopshtet është bërë pasurimi i klasave dhe ateleve me materiale ricikluese, por në 3 prej kopshteve është krijuar tashmë një kënd ose dhomë që shërben si depo e materialeve ricikluese (që kanë sjellë prindërit ose ndonjë organizatë), janë klasifikuar dhe mund të përdoren nga edukatorët e të gjitha grupeve.

Projekti edukativ: Sa i përket projekteve edukative edukatorët dhe drejtoreshat janë të kënaqura me projektet që i kanë realizuar në bashkëpunim me prindërit dhe të mbështetur nga projekti PEDA KOS. Janë 14 kopshte që kanë realizuar projektet me prindër, secili kopsht ka trajtuar tema të ndryshme dhe me specifika të ndryshme por që për qëllim kishin përmirësimin e bashkëpunimit kopsht-familje. Vetëm 1 kopsht, që gjatë këtij viti nuk ka qenë i funksionalizuar për arsye të renovimit, kanë marrë iniciativë që bashkëpunimin me prindër të realizojnë me një aktivitet në shesh të qytetit duke mbledh edukatore, prindër, fëmijë dhe komunitetin përreth. Projektet u realizuan kryesisht nga edukatorët e trajnuara, por kishte edhe edukatore që nuk kanë qenë të trajnuara me projektin PEDA KOS, por në bashkëpunim të ngushtë me kolegen edukatore të trajnuar dhe me drejtoreshën, kanë arritur suksese në realizimin e projekteve.

Këto projekte i kanë motivuar më shumë për të vazhduar punën me një angazhim edhe më të madh, se nëse projekti organizohet dhe realizohet si duhet, ka rezultat dhe janë bindur me këtë, sepse: secili kopsht ka përmbushur objektivat e projektit, prindërit janë përgjigjur dhe përkushtuar të bashkëpunojnë me kopshtin, kanë dhënë ide dhe kanë qenë bashkëprotagonist me fëmijët e tyre në aktivitetet e realizuara. Edukatorët dhe drejtoreshat u shprehen se ndihen më të vlerësuara për punën e tyre pas projektit dhe se këto rezultate po i shërbejnë edhe

grupeve tjera dhe kopshteve tjera të marrin model se si mund të bëjnë prindin bashkëpjesëmarrës në punën me fëmijë.

Sa i përket projekteve tjera në grupet ku janë trajnuar edukatorët, ato kanë vendos në planet e tyre të realizojnë përsëri projekte me tematika të ndryshme. Në 9 kopshte drejtoreshat dhe edukatorët e trajnuara, kanë iniciuar takime me edukatorët e patrajnuara në projektin PEDAPOS dhe së bashku kanë hartuar projekte që do t'i realizojnë në pjesë të tjera të vitit. Ndërsa, në 5 kopshtet tjera, edukatorët e patrajnuara nuk kanë hartuar projekte, por kanë vazhduar punën e tyre sipas planit që kanë përgatitur në fillim të vitit shkollor.

Takimet me të gjitha edukatorët e kopshtit për diskutim dhe projektim, kanë ndodhur në të gjitha kopshtet, por në bazë të përmbledhjes së intervistave të realizuara, ka shumë vështirësi në realizim. Arsytet janë sepse jo të gjitha edukatorët janë të gatshme të marrin përvoja nga edukatorja e trajnuar dhe vazhdimisht kërkojnë trajnime nga profesionistët të tjerë jashtë kopshtit, që do t'u ofronte trajnime, për të vënë në zbatim këtë Qasje. Ka raste kur edhe pyesin, si mund t'i shfrytëzoj materialet e atesës, për çfarë shërbejnë disa nga ato materiale, kërkojnë që të kenë më shumë informata rreth vëzhgimit, etj, por jo në të gjitha rastet, në 5 kopshtet tjera ende edukatorët hezitojnë të bashkëpunojnë mes vete dhe të marrin më shumë përvoja lidhur me QRE.

Vëzhgimi dhe dokumentimi nga drejtoreshat dhe edukatorët paraqitet si nevojë për trajnime të vazhdueshme, sepse theksojnë që kanë marrë përvoja për marrjen e fjalive/komenteve të fëmijëve, marrjen e fotove, punimeve të fëmijëve, lidhjen e tyre me fjalitë, etj. por nuk kanë kaluar në fazën e reflektimit, se çka pas atyre dokumentimeve. Ende kanë nevojë për trajnime që të marrin përvoja si të projektojnë bazuar në dokumentim.

Nga edukatorët paraqitet nevoja për trajnime për fëmijët me nevoja të veçanta, duke theksuar se numri i tyre nëpër grupe po rritet dhe se ato nuk kanë përgatitje të mjaftueshme për të punuar si duhet me ata fëmijë.

Bashkëpunimi me familjen dhe përfshirja e komunitetit: Sipas drejtoreshave dhe edukatoreve të intervistuar, bashkëpunimi me familjen ka filluar të realizohet duke përfshi përvojat e fituara gjatë trajnimit: duke i bërë prindërit bashkëpjesëmarrës në aktivitetet e kopshtit; duke sjellë materiale të riciklueshme dhe materiale të natyrës, duke ofruar mundësi të mbështetjes në forma të ndryshme, duke ofruar mbështetje profesionale kur është e nevojshme, nga prindërit me profesione të ndryshme, si dentist, rrobaqepës, kuzhinier, mjek, fermer, etj.

Projektet e realizuara me prindër kanë dhënë rezultate dhe drejtoreshat u zotuan se janë duke bërë përpjekje që këto përvoja të realizojnë në të gjitha grupet.

Informimi i prindërve për aktivitetet e realizuara me fëmijë, janë duke u bërë në tabelën e informatave dhe në muret hyrëse të kopshteve, ku vendosen foto, punimet e fëmijëve, fjalitë e shkruara se çfarë kanë biseduar dhe si kanë bashkëvepruar me njëri tjetrin, etj. Prindërit njoftohen për realizimin e aktivitetëve të kopshtit edhe përmes email-it, rrjeteve sociale në grupe të mbyllura, viber, etj.

Sa i përket bashkëpunimit me komunitetin, qytetin, shfrytëzimi i shesheve, lumenjve, natyrës, etj., rezultatet tregojnë se nuk është në nivelin e kënaqshëm dhe kjo ende vazhdon të realizohet sipas planifikimi të vizitave që bëhen për nder të festave të ndryshme dhe se ende nuk kanë ndonjë iniciativë për një bashkëpunim të tillë. Përveç 1 kopshti që ishte në renovim dhe që realizoj një aktivitet simbolik në shesh të qytetit. Poashtu, rezultatet paraqesin se planifikimet e vizitave janë për grupet e fëmijëve 5-6 vjeç, e më pak për fëmijët me të vegjël.

Zhvillimi profesional i edukatoreve: Sa i përket zhvillimit profesional, drejtoreshat dhe edukatoret kanë paraqitur pjesëmarrjen në trajnime të tjera përveç trajnimeve të projektit PEDAPOS. Bazuar në këtë, vetëm në 4 kopshte edukatoret kanë ndjekur trajnime të tjera.

Zhvillimi profesional me bazë në kopsht, duke pas parasysh që nga secili kopsht së paku një edukatore dhe drejtoreshat e kanë ndjekë trajnimin, kanë qenë bartëse të përvojave të koleget e tjera të kopshtit. Këto përvoja në 9 kopshte janë bartur dhe janë mirëpritur nga edukatoret, por në 5 të tjera raste as nuk janë mbajtur e as nuk janë mirëpritur nga edukatoret.

Janë dhënë dy arsye pse nuk ka ndodhë trajnimi dhe bashkëpunimi lidhur me QRE në ato kopshte;

- Edukatoret nuk e kanë mirëprit të marrin trajnime nga kolegëja e tyre ose nga drejtoresha e kopshtit, sepse kanë qenë të interesuara të ndjekin trajnimet direkt nga RTM.
- Edukatoret e trajnuara edhe pse kanë qenë të gatshme të përcjellin përvojën të koleget e tyre, shpeshherë nuk kanë qenë të sigurt që po i interpretojnë përvojat në mënyrën më të mirë, tek ato. Nuk kanë praktikuar më parë që të ndajnë përvojat me të tjerët, janë paksa të mbyllur në klasat e tyre dhe ky lloj i bashkëpunimit ka nevojë për kohë dhe për mundësi ndryshimi.

Shkëmbimet Pedagogjike: Shkëmbimi Pedagogjik është një aktivitet që është realizuar në të gjitha kopshtet. Me iniciativën e projektit PEDAPOS, janë mbështetur të gjitha kopshtet të fillojnë të ndajnë përvojat e veta gjatë realizimit të projekteve për të nxitur bashkëpunimin me prindër. Ishte një rekomandim nga viti i kaluar, që është konsideruar se ka nevojë për intervenim më të shpejtë, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për t'i bërë prindërit pjesë të kopshtit. Kopshtet kanë propozuar idetë e projekteve janë hartuar projektet, janë furnizuar me materiale dhe mjete të nevojshme, janë ftuar prindërit për pjesëmarrje, janë hartuar fazat e realizimit duke u përshtatur edhe me kohën kur prindërit janë më të lirë për t'u marrë me aktivitetet në kopsht, janë realizuar të gjitha projektet, janë dokumentuar, janë përgatitur për t'i publikuar në hapësirat adekuate në kopsht, por edhe janë përgatitur për prezantim në takimet e Shkëmbimeve Pedagogjike. Në 5 kopshte janë realizuar Shkëmbimet Pedagogjike, ku kanë marrë pjesë me prezantimet e tyre kopshti nikoqir dhe dy kopshte tjera.

Nga drejtoreshat dhe edukatoret Shkëmbimet Pedagogjike janë cilësuar si zhvillim profesional për vet ato por edhe për koleget e tyre. U kanë mundësuar edukatoreve dhe drejtoreshave të kopshteve tjera të shohin përvoja nga kopshtet përkatëse dhe kanë marrë pjesë një grup më i madh i edukatoreve në këto shkëmbime pedagogjike. Janë ndarë ide e përvoja të ndryshme dhe këto shkëmbime pedagogjike kanë shërbyer si zhvillim profesional

si për edukatorët që kanë realizuar projektet dhe kanë prezantuar ato projekte para të tjerëve, ashtu edhe për edukatorët që kanë pas mundësi me i përcjellë përvojat e kolegeve të tyre.

Këto shkëmbime janë vlerësuar si shumë të dobishme, si nga drejtoreshat ashtu edhe nga edukatorët dhe kanë propozuar që të vazhdojnë të realizohen edhe më tutje, duke trajtuar tema të ndryshme, mundësi të ndryshme të bashkëpunimit me kopshte të tjera.

Kanë kërkuar që këto Shkëmbime Pedagogjike, të vazhdojë të përkrahët nga projekti PEDAKOS, por të mbështeten edhe nga institucionet qendrore e lokale, për shkëmbime të tilla.

Drejtoreshat dhe edukatorët kanë paraqitur tema të tjera që do të ishin në interes për t'u trajtuar në Shkëmbime Pedagogjike, siç janë:

- Eksplorimi i natyrës
- Puna me fëmijë me nevoja të veçanta
- Mbledhja, klasifikimi dhe shpërndarja e materialeve ricikluese
- Vëzhgimi dhe dokumentimi (si të hartohen instrumente të vëzhgimit)
- Si të vijmë deri te një temë e projektit
- Përdorimi dhe shfrytëzimi më i mirë i ateliesë

Janë dhënë edhe ide se si mund të organizohen këto shkëmbime në të ardhmen, si psh:

- Të caktohet temë e njëjtë për projekt dhe secili kopsht të realizoj projektin në mënyrën e vet dhe pastaj të takohen të prezantojnë përvojat e veta secili kopsht.
- Të ftohen kopshtet që nuk kanë qenë pjesë e projektit dhe të prezantohen përvojat.
- Secili kopsht pilot, të jetë nikoqir i Shkëmbimeve Pedagogjike dhe të ftojë nga tri-katër kopshte
- Në Shkëmbime Pedagogjike të ftohen edhe zyrtarë komunal për arsim parashkollor, për të qenë në rrjedha të projekteve dhe të shërbejnë si shkas që të përkrahen kopshtet më shumë niveli lokal dhe qendror.

Përfundimet

Vizita studimore në Itali nga edukatorët dhe drejtoreshat u vlerësua si përvoja më e mirë që e kanë përfituar ndonjëherë në karrierën e tyre. Ato përvoja ndikuan që të fillojnë të përmirësohen praktikat në punën me fëmijë në kopshtet e tyre. Edukatorët dhe drejtoreshat të inspiruara nga trajnimet dhe përvojat e marra në Itali, filluan të pasurojnë kopshtet me materiale të natyrës dhe materiale ricikluese, përdorimin dhe eksperimentimin me ato materiale duke shfrytëzuar mjete të ndryshme për dritë-hije, mjete teknologjike, etj., mbledhjen, klasifikimin dhe deponimin e materialeve ricikluese, duke u dhënë mundësi të gjitha edukatoreve t'i përdorin ato materiale në punë me fëmijët.

Vizita në Itali gjithashtu inkurajoi edukatorët që të krijojnë mundësi për qasje të lirë të fëmijëve në aktivitete, të vëzhgohen fëmijët gjatë procesit edukativ, të dokumentojnë dhe të prezantojnë para të tjerëve dokumentimin, etj. Përvojat e fituara në Itali bënë që të nxitet përfshirja e prindërve në bashkëveprim me kopshtin, në ndarjen e përvojave mes

edukatoreve, në disa raste përfshirja e komunitetit, si dhe në hartimin dhe realizimin e projekteve, në krijimin e hapësirave eksploruese, në përfshirjen e kuzhinës, etj.

Përvojat e fituara në vizitën studimore dhe mundësia për të qenë bashkë për 8 ditë, ka bërë që të këtë një bashkëpunim të ngushtë mes kopshteve të përfshira në projekt (pavarësisht se janë kopshte publike, private, me partneritet, të komuniteteve të ndryshme, etj.) dhe MASHTI, IPK, FE-UP dhe të mbështesin realizimin e qasjes në praktikë.

Sfidë në zbatimin e suksesshëm të kësaj qasje, krahas përvojave të fituara në Itali, është paraqitur pamundësia për të angazhuar ateliristit/e, duke u thirrur në atë se edukatorët nuk janë profesioniste për atele. Një sfidë tjetër konsiderohet edhe mungesa e pedagogëve për t'i përkrahur edukatorët në planifikim dhe realizim të suksesshëm të Qasjes Regjio Emilia në Kosovë dhe inkuadrimi i komunës, qytetit dhe komunitetit në kopsht.

Bazuar në gjetjet e monitorimit, mund të përmblihen disa përfundime të rëndësishme për projektin e realizuar dhe për të ardhmen e realizimit të QRE në kopshtet pilot dhe në shpërndarjen e kësaj qasje në kopshtet tjera.

Sa i përket hapësirave të brendshme dhe të jashtme, janë arritur të krijohen hapësira shitesë dhe të përdoren ato nga të gjitha grupet, kanë filluar të përdorin atelenë, kuzhinën, terasat, oborret, të krijohen hapësira për dritë-hije, të krijohen hapësira për të deponuar materialet e mbledhura ricikluese, të shfrytëzohen deri në tri e më shumë hapësira edukative, të krijojnë hapësira për mbjelljen e perimeve dhe bimëve, të vendosin tabela për informim të prindërve dhe për dokumentim të projekteve, etj., por nevojitet një riorganizim i punës edukative për shfrytëzimin e mjedisit, ku hapësirat edukative të jenë të hapura, klasë të hapura, shfrytëzim i këndeve, korridoreve, atelesë, terasave, ambientit të jashtëm të gjitha të shfrytëzohen njëkohësisht nga fëmijët dhe nga stafi i kopshtit, të ketë bashkëveprim të fëmijëve me të rriturit.

Ateletë ose mini-ateletë në klasë, të jenë hapësira ku zhvillohen „100 gjuhët e fëmijës” dhe praktikatat tregojnë se janë duke u shfrytëzuar atelietë dhe çdo ditë e më shumë po zhvillohet kjo përvojë, por ka ende nevojë për profesionalizëm të edukatores në shfrytëzimin e ateliesë.

Materialet dhe mjetet janë duke u përdorur dhe shfrytëzuar në mënyrën sikur kanë përfituar përvoja nga QRE, ka materiale të shumëllojshme, të qasshme nga fëmijët, materiale ricikluese, materiale të natyrës, materiale didaktike, argjilë, mjete të ndryshme teknologjike, me dritë, me zmadhues, llupa, etj. Është e nevojshme që me përdorimin e këtyre mjeteve dhe materialeve, t'u jepet mundësi fëmijëve të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre dhe të jenë më të pavarur, pa u ndikuar nga të rriturit.

Projektet edukative janë një përvojë e mirë e cila është zbatuar nga të gjitha kopshtet pilot dhe ka rezultuar me sukses, janë realizuar projekte me tema të ndryshme dhe këto projekte kanë sjellë një frymë të re në kopshtet tona duke e bërë familjen pjesë të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me kopshtin.

Edukatorët dhe drejtoreshat e trajnuara me QRE janë duke bërë përpjekje që këto përvoja të fituara t'i ndajnë me edukatorët e tjera të kopshtit, gjë që shumë nga ato kanë interesim dhe kanë marrë këto përvoja.

Vëzhgimi dhe dokumentimi janë dy praktika që janë realizuar gjatë projekteve dhe kanë filluar të bëhen pjesë e përditshmërisë në kopshte, duke dokumentuar secilin projekt dhe duke e vendosur në vende të dukshme. Edukatorët kanë përvoja në vëzhgim dhe

dokumentim, por kanë nevojë për reflektim dhe projektim bazuar në ato vëzhgime dhe dokumentime.

Bashkëpunimi me familjen ka filluar të bëhet poashtu një praktikë e mirë në kopshte dhe përfshirja e QRE, ka bërë që prindërit të jenë pjesë e kopshtit, në aktivitete, të sjellin materiale.

Bashkëpunimi me komunitetin realizohet me programe të ndryshme dhe vizita lidhur me festat apo me ndonjë datë historike, por është e nevojshme një lidhje më e ngushtë e kopshtit me qytetin dhe komunitetin, që të jenë të gjithë në shërbim të mirëqenies dhe mirërritjes së fëmijëve si pjesë e qytetit dhe komunitetit.

Shkëmbimet Pedagogjike që janë realizuar në kopshte, janë një e arritur e mirë për kopshtet, sepse kanë realizuar projektet. Kjo ishte një mundësi e mirë për prezantim të punës por edhe për të marrë dhe dhënë ide të ndryshme për projekte në të ardhmen. Është paraqitur e nevojshme të vazhdojnë të realizohen Shkëmbimet Pedagogjike, me projekte tjera.

Zhvillimi profesional i edukatoreve është një e arritur tjetër e shtrirjes së QRE në kopshtet pilot, ku përmes projektit PEDAKOS përfituan zhvillim profesional nga ekspertët e kësaj qasje, në Itali dhe në Kosovë. Përvojat e fituara edukatorët dhe drejtoreshat po bëjnë përpjekje që t'i shtrijnë tek grupet tjera, tek edukatorët e patrajnuara brenda kopshteve, por edhe tek kopshtet tjera që nuk kanë qenë kopshte pilot për QRE.

Rekomandimet

Bazuar në rezultatet e monitorimit është nxjerrë një rekomandim i përgjithshëm nga i cili dalin disa rekomandime specifike që janë të nevojshme të shqyrtohen dhe të merren për bazë, për realizim të suksesshëm të QRE dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë:

1. Krijimi i mekanizmave për të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme, realizimin cilësor të QRE në kopshtet pilot dhe më gjerë. Mekanizmat mund të krijohen me përkrahje të projekteve nga RTM dhe donator, që mbështesin këtë Qasje, por edhe me përkrahje të nivelit qendror (MASHTI) dhe lokal (Komuna) që merren me edukimin në Kosovë, me përkrahjen e partnerëve tjerë (FE-UP, IPK, Kolegjiumi i drejtorëve të kopshteve, etj.) si dhe me përkrahjen e mençmentit të kopshteve dhe vet edukatoreve. Mbështetja e vazhdueshme do të mundësonte që praktikat e deritashme të fuqizohen edhe më shumë, e ato janë:

- Hapësirat e brendshme dhe të jashtme të kopshteve të jenë të hapura, të ndërlidhura dhe të favorizojnë më shumë eksplorim, ndërveprim, kuriozitet, kreativitet të fëmijët, që mjedisi të jetë „edukatori i tretë” (Menagjmenti i kopshteve dhe edukatorët)
- Të ofrohet përkrahje e vazhdueshme dhe zhvillim profesional i edukatoreve për të shfrytëzuar më me profesionalizëm atelienë si një kulturë ku zhvillohen „100 gjuhët e fëmijës”. (RTM, Donatorët, MASHTI).
- Bazuar në përvojat në Itali, roli i pedagogut ishte shumë i madh, në realizimin e QRE, në planifikimin e projekteve, në bashkëpunimin mes edukatoreve të kopshteve, në bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin, me qytetin me komunën dhe direkt

mbështetje në cilësinë e punës. Për realizim mirëfilli dhe shtrirje të kësaj qasje është e nevojshme që në kopshtet tona të pranohen Pedagog/e, që do të trajnohen si Pedagog të QRE (Komuna, MASHTI- për pranim në punë të pedagogëve) dhe (RTM, MASHTI, Donatorë, FE-UP- për përgatitjen profesionale apo trajnimin e tyre).

- Të ofrohet përkrahje e vazhdueshme dhe zhvillim profesional i edukatoreve për vëzhgim me fokus në një çështje (në hartimin e instrumenteve të vëzhgimit), për reflektim dhe projektim, pas vëzhgimit dhe dokumentimit të proceseve edukative. (RTM, Donatorët, MASHTI)
- Të krijohen kushtet dhe mundësitë të realizohet ndarja e përvojave të QRE me të gjitha edukatorët brenda kopshtit dhe te kopshtet tjera (Menagjmenti i kopshtit, edukatorët e trajnuara, Kolegjiumi i Drejtorëve)
- Të ofrohen trajnime nga profesionistë të zbatimit të QRE, për të gjitha edukatorët në Kosovë (RTM, Donatorë, MASHTI etj)
- Të ndryshoj praktika e shabllonizmit dhe paraprogramimit të punës me fëmijët dhe të nxitet hartimi i më shumë projekteve, bazuar në nevojën dhe interesimin e fëmijëve duke u përqendruar më shumë në procesin që zhvillohet e jo në produktin që arrihet (Menagjmenti i kopshteve dhe edukatorët)
- Të sigurohen mundësitë për të mbështetur integrimin e fëmijëve me të drejta të veçanta gjatë implementimit të kësaj qasjeje, me mbështetje me asistentë dhe staf shtesë. (Komunat, MASHTI)
- Të angazhohen më shumë kopshtet për të nxitur bashkëpunimin me komunitetin dhe qyteti të bëhet pjesë e integruar e punës së kopshtit dhe të jetë pjesë e bashkëudhëtimit me kopshtin (Menagjmenti i kopshtit, edukatorët, prindërit, komuna, Kolegjiumi i Drejtorëve)
- Të vazhdojnë shkëmbimet pedagogjike dhe të trajtohen tema të ndryshme dhe organizime të ndryshme (RTM, MASHTI, IPK, Kopshtet pilote, edukatorët e trajnuara, OJQ, Donatorë, Kolegjiumi i Drejtorëve)